



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 1208 prot.

Shkodër, më 22.1. 2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin:

“PËR NJE NDRYSHIM NË VKB NR.27 DATË 01.06.2016 “PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR, SHPERBLIMIN E ANËTARËVE TIJ DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TE PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE, SPORTIVE, RINORE DHE PROMOVIMIN E TERRITORIT NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR”

Duke ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 1208/prot.

Shkodër, më 27.1.2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë _____.2025

“PËR NJE NDRYSHIM NË VKB NR.27 DATË 01.06.2016 “PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR, SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TIJ DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TE PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE, SPORTIVE, RINORE DHE PROMOVIMIN E TERRITORIT NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____/____/2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 25, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të Ligjit nr.44/2015“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligji nr. 10352 datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar;”, Vendimin nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e këshillave artistiko - kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre”, të ndryshuar; Udhëzimin nr.1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko - kulturor”, VKB nr.27, date 01.06.2016 “ Per ngritjen e Keshillit artistiko kuturore, artistike, sportive dhe rinore, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në bashkinë Shkodër” të ndryshuar me VKB nr. 40 datë 26.10.2023”, VKB nr.76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit nr. ____prot, datë _____ të Drejtorisë së Përgjithsme të Kulturës dhe Sportit;

VENDOSI :

1. Të miratojë ndryshimin dhe zëvendësimin e anëtarëve të keshillit artistiko-kulturor të miratuar me VKB nr. 27 datë 01.06.2016 “Për Ngritjen e Këshillit Artistiko-Kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve

kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në bashkinë shkodër” të ndryshuar me VKB nr. 40 datë 26.10.2023”, si më poshtë:

- Znj. Amila Gjyrezi zëvendësohet me Znj. Sara Smajaj Drejtor i Drejtorisë së Kulturës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Drejtorisë së Kulturës dhe Sportit;
 - Znj. Paskualina Gruda zëvendësohet me Z. Agim Bajko, në fushën e skenës dhe kinematografisë.
2. Pikat e tjera të VKB-se nr.27, datë 01.06.2016 “ Per ngritjen e Keshillit artistiko kuturore, artistike, sportive dhe rinore, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në bashkinë Shkodër” të ndryshuar me VKB nr. 40 datë 26.10.2023” mbeten në fuqi.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

Zv/Kryetar

Rudin Beka

**Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës,
dhe e Sportit**

PANDI LACO

Pandi Laco

**Drejtoria e Përgjithshme Juridike,
Burimeve Njerëzore dhe Sherbimeve Mbështetëse**

Denis Lesha

Denis Lesha

*Dr. Kultura
Sara Smajaj*

Denis Lesha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KULTURËS DHE SPORTIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2025

RELACION

“PËR NJE NDRYSHIM NË VKB NR.27 DATË 01.06.2016 “PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR, SHPERBLIMIN E ANËTARËVE TIJ DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TE PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE, SPORTIVE, RINORE DHE PROMOVIMIN E TERRITORIT NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR”

Këshillit Bashkiak, Shkodër

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Shkodër ka ndër prioritetet e punës së saj shtimin dhe përmirësimin e aktiviteteve kulturore artistike, rinore, sportive dhe shërbimeve argëtuese, që kanë si qëllim fuqizimin e politikave artistike, kulturore, sportive dhe promovimin e territorit.

Gjatë viteve të fundit mbështetja për realizimin aktiviteteve artistiko - kulturore, sportive, rinore dhe promovimit të territorit është rritur nëpërmjet shtimit të fondeve të parashikuara për realizimin e projekteve të paraqitura nga subjekte të ndryshme të fushave përkatëse.

Kjo mbështetje financiare kryhet në përputhje me projektet dhe fondet e përcaktuara për këtë qëllim nga bashkia e Shkodrës sipas miratimit nga Këshilli Bashkiak të Buxhetit të vitit përkatës.

Këshilli Artistiko-Kulturor mbështet bashkinë Shkodër në vlerësimin e cilësisë së projekteve të paraqitura nga subjektet e interesuara, projekte që i shërbejnë realizimit të objektivave të bashkisë në fushën e zhvillimit të artit, kulturës sportit, rinisë dhe promovimit të territorit në bashkëpunim me këto subjekte. Anëtarët e këshillit artistiko-kulturor kanë mandat 2 vjeçar.

Me VKB nr. 40 datë 26.10.2023 “Për disa ndryshime në VKB nr. 27 datë 01.06.2016 “Për ngritjen e këshillit artistiko-kulturor, shperblimin e anëtarëve tij dhe miratimin e rregullores së financimit te projekteve kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në bashkinë Shkodër”, i ndryshuar, është miratuar përbërja e këshillit artistiko-kulturor për periudhën 2023-2025. Me qëllim që të plotësohen vendet vakante të krijuara për shkak të ndryshimit të pozicionit

të punës së Znj Amila Gjyrezi, si dhe të dorëheqjes për arsye personale të Znj. Paskualina Gruda, propozojmë zëvendësimin e tyre me figura të rëndësishme të artit dhe kulturës: Znj Sara Smajaj, Drejtor i Kulturës, Z. Agim Bajko, përfaqësues i artit skenik dhe kinematografik.

Sa më sipër në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar; VKM nr 121 datë 25.2.2005, për disa ndryshime në vendimin 540, datë 21.12.1992, "Për krijimin e Këshillave të Kulturës dhe shpërblimin e tyre" si dhe të Udhëzimit Nr 1, datë 24.05.2005 të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko –kulturore", VKB VKB nr. 76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër", propozojmë për miratim Keshillit Bashkiak projekt vendimin "Për një ndryshim në VKB nr. 27 datë 01.06.2016 "Për ngritjen e Këshillit Artistiko-Kulturor, shpërblimin e anëtarëve tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në bashkinë Shkodër", të ndryshuar me vkb nr. 40 datë 26.10.2023."

Duke Ju falenderuar !


KRYETAR

Benet BECI

Drejtorja e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit

DANI LACO


Drejtorja e Kulturës

Sara Smajaj


Drejtorja e Sportit

Auron Miloti
